



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
NË ARSIMIN E LARTË

*Studentët vlerësojnë*

# SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

2019

Takim informues

[info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

[www.ascal.al](http://www.ascal.al)



# SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

- ❑ Mekanizëm për matjen e kënaqshmërisë së studentëve në lidhje me cilësinë në arsimin e lartë.
- ❑ Nxirren informacione për funksionimin e arsimit të lartë/veprimtarive akademike në:
  - Universitete
  - Kolegje Universitare
  - Akademi
  - Kolegje Profesionale të Larta

# SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

- Një nga instrumentat e kontrollit të jashtëm të cilësisë nga ASCAL bazuar në Ligjin 80/2015, VKM 109 datë 15.02.2017 dhe VKM 783 datë 26.12.2018.
- Nuk mbledh informacion për pedagogë apo lëndë specifike.
- Mbledh informacione mbi kënaqshmërinë e studentëve me shërbimin që ato marrin nga IAL ku ndjekin studimet e tyre.

# SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

## SKS është i rëndësishëm sepse:

- Jep informacione reale e të besueshme për cilësinë e Arsimit të Lartë, bazuar tek mendimi dhe opinioni i studentëve.
- Ndhmon vetë *universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta* në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së tyre.
- I jep informacionet e nevojshme drejtuesve/titullarëve të *universiteteve, kolegjeve universitare, akademive dhe kolegjeve profesionale të larta*, për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve, bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve.

# SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

- Informon studentët aktualë, për cilësinë e Arsimit të Lartë në *universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta* ku ata studiojnë.
- Informon studentët e rinj për cilësinë e mësimdhënies në *universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta* ku ata dëshirojnë të ndjekin studimet e tyre.
- Informon publikun në tërësi, për cilësinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## I. Organizimi i institucionit, menaxhimi dhe funksionimi i tij

- **njësi kryesore** që janë: *fakultetet, institutet kërkimore-shkencore*;
- **njësi bazë**, që janë: *departamentet, qendrat kërkimore-shkencore* të cilat funksionojnë brenda një fakulteti apo instituti kërkimor-shkencor;
- si dhe në njësi të tjera siç janë *laboraret, bibliotekat, sallat e informatikës*, etj., që quhen **njësi ndihmës-akademike**;
- dhe *sekretaritë mësimore, zyrat e ndryshme*, që quhen **njësi administrative**.

# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## II. Burimet

- **infrastruktura fizike** (*salla leksioni, seminari, ambjente sportive, ambjente çlodhëse, etj.*);
- **infrastruktura didaktike** (*laboratorë, biblioteka, internet, etj.*);
- **stafi akademik** (*komunikimi dhe mbështetja nga pedagogët, etj.*);
- **mundësitë fizike dhe financiare** që jep Institucioni për aktivitete të ndryshme studentore (*psh. për mbledhjet e Qeverisë/Këshillit Studentor, aktivitete sociale, kulturore, sportive, etj.*)

# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## III. Kurrikulat, përmbajtja dhe përditësimi

- Përmbajtja e programit të studimit.
- Lëndët që zhvillohen në programin e studimit.
- Si janë të organizuara lëndët (leksione, seminare, praktikë, detyra kursi, mënyra e vlerësimit, provimet, temat që trajtohen në çdo orë leksioni, literatura e detyruar dhe ndihmëse, etj.)



# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## IV. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi

- Mendime dhe vlerësimi i studentëve për trupën pedagogjike (psh. aftësitë e tyre në shpjegimin e njohurive, koncepteve dhe metodave të mësimdhënies që përdorin gjatë leksioneve të ndryshme).
- Vlerësime mbi materialet që ju vihen në dispozicion nga pedagogët.
- Transparenca, paanësia në vlerësimin e pedagogëve për studentët, për detyrat e ndryshme, esetë, provimet e ndërmjetme dhe vlerësimin final të lëndës.

# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## V. Aktiviteti kërkimor, projekte, studime, botime

- Studentët japin mendime dhe vlerësime mbi mbështetjen nga institucioni për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kërkimore-shkencore apo nxitjen dhe mbështetjen e ideve të reja.
- Institucioni ju mundëson apo jo financime, ju vë në dispozicion bazë materiale si laboratore, kompjutera, tekste të ndryshme, për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore, etj.
- Pedagogët ju përfshijnë dhe mbështesin në botimet e tyre, në kërkimin shkencor, në pjesëmarrje ose organizimin e konferencave studentore apo në mobilitete (psh. *programet Erasmus*) që lidhen me programin tuaj të studimit.

# PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

## VI. Studentët dhe mbështetja e tyre

- ▶ Studentët japin mendime dhe vlerësime për:
  - informacionin që kanë/marrin para regjistrimit në Institucion;
  - mbështetjen që japin zyrat e ndryshme administrative gjatë kryerjes së studimeve;
  - lehtësirat financiare që mund të përfitojnë si dhe rastet dhe mënyrat e përfitimit të tyre.
- ▶ A merr institucioni mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve online ose me shkrim, fokus grupeve, për cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturës, përfshirjen në aktivitete kërkimore-shkencore, etj.?
- ▶ Studentët gjithashtu mund të vlerësojnë masat konkrete dhe përpjekjet që bën Institucioni për të mundësuar lidhjen e tyre me tregun e punës dhe ofertat e punësimit.

# ZHVILLIMI I SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

- Pyetësoni zhvillohet online nëpërmjet *platformës* që është përgatitur për këtë qëllim.
- Gjatë periudhës Prill-Maj, studentët do të njoftohen nëpërmjet email për fillimin dhe link-un e plotësimit të pyetësonit.
- Studentët kanë mundësi ta plotësojnë atë në çdo kohë nga çdo ambjent, si nga aparatet e ndryshme celular dhe nga sallat e kompjuterave të vëna në dispozicion nga Institucioni.
- Është e rëndësishme plotësimi i pyetësonit nga **çdo student**, dhënia e përgjigjeve **të sakta** dhe **reale**.

# ZHVILLIMI I SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

- ❖ Në disa pyetje studenti përgjigjet me **po/jo/nuk e di**.
- ❖ Ka dhe pyetje ku si përgjigje mund të zgjedhë **më shumë se një** alternativë.
- ❖ Në disa pyetje është lënë mundësia për dhënien e një **teksti** të shkurtër përshkrimor.
- ❖ Në përgjithësi pyetjet janë të organizuara në mënyrë të tillë që studenti të japë mendim ose vlerësim të klasifikuar në 5 nivele duke filluar nga vlerësimi *minimal* në *maksimal*:

## **Konkretisht:**

- *Vlerësimi 1 – shumë keq / pa përgjigje*
- *Vlerësimi 2 – keq / aspak dakord*
- *Vlerësimi 3 – mjaftueshëm/ as pro as kundër*
- *Vlerësimi 4 – mirë / dakord*
- *Vlerësimi 5 – shumë mirë / plotësisht dakord*

# TRANSPARENCA, ANONIMATI DHE KONFIDENCIALITETI

- Procesi i plotësimit të pyetësorit është **anonim** dhe bazohet tërësisht në **opinionin individual të studentëve** për Institucionin ku ata studiojnë.
- SKS do të ofrohet në **dy gjuhë** (*shqip dhe anglisht*) për t'u dhënë mundësi plotësimi studentëve vendas dhe të huaj.
- Një email do i dërgohet çdo studenti me link për plotësimin e pyetësorit.

## REZULTATET DHE RAPORTI PËRFUNDIMTAR

- Në përfundim të procesit hartohet raporti analitik me rezultatet e pyetësorëve, shoqëruar me analizat përkatëse për institucionet e ndryshme për t'ju përgjigjur interesit publik apo të politikëbërjes.

## PËRMBYLLËSE

- Studentët gjatë gjithë procesit kanë asistencën e nevojshme për sqarime, informacione dhe suport teknik nga Grupi i Punës, stafi i ASCAL dhe Koordinatorit i Institucionit.



**FALEMINDERIT!**  
**PYETJE DHE DISKUTIME**